**LIGJ**
**Nr. 90/2014**

# PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 10 171, DATË 22.10.2009,"PËR PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pas shkronjës "g", të pikës 1, të nenit 5, shtohen shkronjat "gj" dhe "h" me këtë përmbajtje:
"gj) punonjësi social;
h) psikologu.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.7.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8671, datë 1.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**